



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 657/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Ferki Xhaferi dhe Burim Ademi anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Kushtrim Zuka, duke vendosur lidhur me apelet e Nezir Çoçajt nga Prizreni, kandidat për deputet nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), të paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) Nr.860-2021, të datës 04.03.2021, me të cilat ka kërkuar rinumërim të votave në vendvotimet e apeluara, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 06.03.2021, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHEN të pabazuara apelet Anr.657/2021, Anr.658/2021, Anr.659/2021, Anr.660/2021, Anr.661/2021, Anr.662/2021, Anr.663/2021, Anr.664/2021, Anr.665/2021, Anr.666/2021, Anr.667/2021, Anr.668/2021, Anr.669/2021, Anr.670/2021, Anr.671/2021, Anr.672/2021, Anr.673/2021, Anr.674/2021, Anr.675/2021, Anr.676/2021, Anr.677/2021, Anr.678/2021, Anr.679/2021, Anr.680/2021, Anr.681/2021, Anr.682/2021, Anr.683/2021, Anr.684/2021, Anr.685/2021, Anr.686/2021, Anr.687/2021, Anr.688/2021, Anr.689/2021 dhe Anr.690/2021, të gjitha të datës 05.03.2021, të paraqitura nga Nezir Çoçaj nga Prizreni, kandidat për deputet nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), të paraqitura kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), të datës 04.03.2021, me të cilën ka kërkuar rinumërim të votave në vendvotimet 2116B-3D, 2116B-01R, 2105B-04D, 2015B-D3R, 0311E-03D, 0311E-02R, 2033A-05R, 2033A-04R, 2101B-4R, 2033A-06D, 2033A-03R, 2026A-4D, 2026A-03R, 2026A-02R, 2026A-01R, 2039A-02D, 2039A-01R, 0303E-03D, 2502X-01R, 2502X-02R, 2539D-01D, 2540D-01D, 2528D-02R, 2528D-03D, 2533D-01R, 2538D-01D, 0302X-01R, 0302E-04R, 2501D-05R, 2501D-06R, 2537D-01D, 0301X-04D, 0301E-03R dhe 0301X-02R.

A r s y e t i m

Me datë 05.03.2021, kandidati për deputet nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Nezir Çoçaj ka paraqitur në PZAP apelet Anr.657/2021, Anr.658/2021, Anr.659/2021, Anr.660/2021, Anr.661/2021, Anr.662/2021, Anr.663/2021, Anr.664/2021, Anr.665/2021, Anr.666/2021, Anr.667/2021, Anr.668/2021, Anr.669/2021, Anr.670/2021, Anr.671/2021, Anr.672/2021, Anr.673/2021, Anr.674/2021, Anr.675/2021, Anr.676/2021, Anr.677/2021, Anr.678/2021, Anr.679/2021, Anr.680/2021, Anr.681/2021, Anr.682/2021, Anr.683/2021, Anr.684/2021, Anr.685/2021, Anr.686/2021, Anr.687/2021, Anr.688/2021, Anr.689/2021 dhe Anr.690/2021, të gjitha të datës 05.03.2021, me të cilën pretendon se në vendvotimet 2116B-3D, 2116B-01R 2105B-04D, 2015B-D3R, 0311E-03D, 0311E-02R,

2033A-05R, 2033A-04R, 2101B-4R, 2033A-06D, 2033A-03R, 2026A-4D, 2026A-03R, 2026A-02R, 2026A-01R, 2039A-02D, 2039A-01R, 0303E-02D, 2502X-01R, 2502X-02R, 2539D-01D, 2540D-01D, 2528D-02R, 2528D-03D, 2533D-01R, 2538D-01D, 0302X-01R, 0302E-04R, 2501D-05R, 2501D-06R, 2537D-01D, 0301X-04D, 0301E-03R dhe 0301X-02R, në formularin e votave të kandidatëve nuk janë të përfshira të gjitha votat që i njëjti ka marrë si kandidat, pasi që të njëjtat nuk janë përshkruar drejtë nga radhët e komisionerëve, duke konstatuar jo saktë gjendjen faktike, gjegjësisht numërimin e votave. Këtë deklaratë pretendon se e mbështetë në deklaratat e familjarëve dhe miqve të tij, të cilët sipas parashtruesit të apeleve kanë votuar në këto qendra votimi, dhe të njëjtit janë të shqetësuar për mos numërimin e votave sipas vullnetit të tyre. Më tutje thekson se konform nenit 89, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, e drejta e votës së tyre është e fshehtë. Panelit i propozon që apelet të aprovohen si të bazuara, dhe të urdhërohet KQZ që të bëjë rinumërimin e vendvotimeve të përshkruara në formularët e apeleve.

Paneli, pasi që shqyrtoj apelet vlerësoi se:

Apelet janë të pabazuara

Paneli, paraprakisht ka vlerësuar se apelet: Anr.657/2021, Anr.658/2021, Anr.659/2021, Anr.660/2021, Anr.661/2021, Anr.662/2021, Anr.663/2021, Anr.664/2021, Anr.665/2021, Anr.666/2021, Anr.667/2021, Anr.668/2021, Anr.669/2021, Anr.670/2021, Anr.671/2021, Anr.672/2021, Anr.673/2021, Anr.674/2021, Anr.675/2021, Anr.676/2021, Anr.677/2021, Anr.678/2021, Anr.679/2021, Anr.680/2021, Anr.681/2021, Anr.682/2021, Anr.683/2021, Anr.684/2021, Anr.685/2021, Anr.686/2021, Anr.687/2021, Anr.688/2021, Anr.689/2021 dhe Anr.690/2021, të datës 05.03.2021, të cilat për nga përmbajtja janë të njëjta, për nga natyra e shkeljes së pretenduar janë të njëjta, paraqitës i të gjitha apeleve është kandidati për deputet Nezir Çoçaj, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), prandaj Paneli, bazuar në nenin 8 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave Nr.02/2015, të PZAP-it, në të cilën përcaktohet se: *“Me qëllim të lehtësimit të shqyrtimit të ankesave kryesuesi i panelit vendimmarrës mund të vendos ta bëjë bashkimin e ankesave që përmbajnë në vete çështje të ngjashme dhe se ato ankesa të trajtohen me një vendim”*, bëri bashkimin e apeleve dhe për të njëjtat vendosi me një vendim, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apeleve në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur mos përfshirje të votave të parashtruesit të apeleve gjatë numërimit të votave, për faktin se thëniet e tij nuk mbështetën në asnjë provë konkrete por janë të imagjinuara sepse pritjet e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mos përfshirje të saktë të rezultatit si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apele.

Paneli i shqyrtoi edhe deklaratat e bashkangjitura në apele nga ana e ankuesit mirëpo të njëjtat nuk janë bazë e mjaftueshme se në këto vendvotime ka pasur parregullsi, rrjedhimisht

pretendimi ankimor i parashtruesit te ankesës se deklaratën e mbeshtete ne pohimet e miqeve te tije, paneli rikujton se vota eshte e fshehur, dhe ajo shpërfaq vullnetin e qdo votuesi ne fletëvotim dhe ne asnjë menyre nuk mund te merret si fakt provues pretendimi i till se nje votues pohon faktin se ka votuar ne ndonjërin nga vendvotimet qe kandidati ka pretenduar ne ankese. Në rastin konkret ankuesi nuk ka paraqitur asnjë provë tjetër pos deklaratave, duke mos bashkangjitur as Formularin i Përputhjes së Rezultateve, e as Formularin e Rezultateve të Kandidatëve. Andaj në mungesë të provave paneli vendosi që apelet e paraqitura nga Nezir Çoçaj kandidat për deputet nga subjekti politik PDK, të refuzohen si te pa bazuara.

Andaj, Paneli vlerësoi se apelet e parashtruar nga Nezir Çoçaj i subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave për kandidat..

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.657/2021 më datën 06.03.2021

Kryesuesi i Panelit

Zyndi Haziri



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.